



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Integrimit Evropian
Ministarstvo za Evropske Integracije / Ministry of European Integration



Datë: 23/10/ 2018

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integrimit Evropian, në mbështetje të Nenit 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), duke u bazuar në Nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), në bazë të nenit të nenit 10 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-222, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin 05/L-007), dhe nenit 12 dhe 13 të Rregullores mbi Kriteret Standardet the Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integrimit Evropian, nxjerrë këtë:

VENDIM

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekte/programet të organizatave jo-qeveritare në fushën e integrimit Evropian.

I

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Ministrisë së Integrimit Evropian, kodit ekonomik 2100 Subvencionet në kuadër të programit/nën programit 21811318 Administrata Qendrore mbështetje financiare,

II

1. Mjetet e përmendura në nenin do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshinë:
 1. Teksti i thirrjes publike
 2. Udhëzimet për aplikantët
 3. Formularët e aplikimit
 4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
 5. Format për raportimin e zbatimit të projektit
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
 2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
 3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta
 4. Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme)

5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike.
 6. Deklarata për Aktivitetet e kontraktori e përmendur në përshkrimin e aktiviteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet).
3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
 2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
 3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

IV.

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare (<http://www.mei-ks.net/sq/>).

V.

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VI.

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.

IX.

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit

Me respekt,

Kushtrim Çukaj

Sekretar i Përgjithshëm

Ministria e Integritimit Evropian

